



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 06.04.2023

Nr: 51

Ora: 14:00

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 46, DATË 04.04.2023 TË DEPOZITUAR NGA Z. ÇLIRIM HOXHA

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 06.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Z. Çlirim Hoxha ;

OBJEKT:

- Kundërshtimin e vendimit nr. 19, datë 29.03.2023 të K.Z.A.Z nr. 72, bashkia Devoll.
- Shqyrtim i kërkesës për regjistrim të z. Hoxha, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore, në bashkinë Devoll.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja “c”, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Z. Çlirim Hoxha ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 46 regj., datë 04.04.2023. Në mbledhjen e datës 06.04.2023, ora 15:00, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 46 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhori Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet përshqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 46, datë 04.04.2023, të paraqitur nga “z. Çlirim Hoxha.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 06.04.2023, ora 15:00.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar